



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KUKËS

Nr.471 prot.

Kukës, me 20.02.2023

**Drejtuar:** Njesia Administrative Maliq

**Lenda:** Kërkojmë afishimin e njoftimit të seances gjyqesore për të pandehurin **Gofile Gjergo**, e bija e Zef dhe Leze, dl. 27.07.1967, lindur në Bukove Tropoje e banues në fshatin Sovjan Korçe

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës është duke u gjykuar çështja penale nr.569 akti në ngarkim të të pandehurit **Gofile Gjergo**

**Akuzuar:** Për kryerjen e veprës penale të “Kalim I paligjshëm I kufirit shtetëror”, parashikuar nga neni 297 të Kodit Penal

Për sa më sipër, referuar dispozitave ligjore të K.Pr.Penale, kërkojmë nga ana juaj si njësi administrative që ka nën juridiksion të saj vendbanimin e të pandehurit, që të bëni afishimin e komunikimit të dates së seances gjyqesore të radhës të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit **Gofile Gjergo**

Afishimi i këtij komunikim vendimi të bëhet në këndin para institucionit të Bashkisë Korçe dhe Njesisë Administrative Maliq.

Lutemi të na konfirmoni sa më shpejt mbi realizimin e kësaj shpallje, e cila duhet të qendrojë e afishuar për një afat kohor 15 ditor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.



S. tele- Informacioni  
dt 01.03.2023





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KUKËS

Kukës, me 20.02.2023

SHPALLJE - PUBLIKE

**“Për njoftimin e dates se séances gjyqesore për të pandehurin Gofile Gjergo”**

**Gofile Gjergo**, e bija e Zef dhe Leze, dl. 27.07.1967, lindur ne Bukove Tropoje e banues ne fshatin Sovjan Korce

**Akuzuar:** Për kryerjen e veprës penale të “Kalimit te paligjshem te kufirit”, parashikuar nga neni 297 te Kodit Penal

Shqyrtimi gjyqësor i çështjes është në fazën e njoftimit dhe te paraqitjes së palëvë.

Njoftimi i të pandehurit në gjendje te lire **Gofile Gjergo** nuk është mundur te realizohet përmes procedurave standart te njoftimit (*neni 140 i K.P.Penale*), dhe as nepermjet kerkimit policer nga ana e Komisariatit te Policise Korce , ne adresen e dhene nga prokuroria fshatin Sovjan Korce për shkak se nga Kom.Policise eshte kthyer pergjigje se ky shtetas eshte I larguar pa adrese

Referuar ketij konfirmimi dhe dispozitave te K.Pr.Penale njoftimi i të pandehurit te lire do te kryhet nëpërmjet Policisë Gjyqësore (*nenet 132,141 te K.P.Penale*), si dhe me ane te shpalljes publike konform nenit 140 te K.Pr.Penale.

Për sa më sipër, njoftohet I pandehuri **Gofile Gjergo** qe séanca gjyqësore e kesaj ceshtje do të zhvillohet datë **07.03.2023 ora 13:00**.

**Shënim:** Ky komunikim vendimi, në bazë të dispozitave të K.Pr.Penale, do të afishohet me afat 15 ditor në këndin e njoftimeve të Bashkisë Korce ku i pandehuri ka vendbanimin.

